

AKTI I THEMELIMIT

PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “MERKAM”

Në Tiranë, sot me datën, 30.06.2024 (dy mijë e njëzetekatër) unë e nënshkruara, **Mersilda Kamberi**, e bija e Haxhiut, e datëlindjes 16/09/1987, lindur në Tiranë, dhe banuese në Tiranë, Bashkia Vorë, Njësia Administrative Prezë, me Numer Identifikimi Personal **I75916033Q**, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, në cilësinë e ortakut themelues, krijoj shoqërinë tregtare të mëposhtme në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar sipas dispozitave që vijnë:

Neni 1

LLOJI I SHOQËRISË

1.1 Shoqëria që po krijoj është e llojit: Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar.

Neni 2

EMËRTIMI DHE SELIA

2.1 Emërtimi i shoqërisë është: **MERKAM** – Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, që në mjaft raste, në dokumentet e krijimit të saj, do të shkruhet edhe shkurt: “Shoqëria”

2.2 Selia e Shoqërisë është: Tiranë, Njësia Bashkiake Nr.4, Rruga Selaudin Zorba, ZK.8120, Nr.Pasurie 9/1313/ND +1/31, Pll.87, Shk.44, Kati 4, Ap.31.

2.3 Kontaktet të tjera vullnetare janë: Emri Tregtar: **MERKAM DESIGN & CONSULTING**, Telefon: +355684150350, Email: info@merkamltd.com

Neni 3

KOHËZGJATJA

3.1 Shoqëria do të funksionojë për një periudhë kohe të papërcaktuar.

Neni 4


OBJEKTI DHE QËLLIMI I VEPRIMTARISË

Neni 4/1

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

4.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë si më poshtë:

Atelier. Skicim dhe realizim veshje e aksesore artistike për të rritur dhe fëmijë. Fustane e vello nusërie, kostume për meshkuj, veshje e aksesore të tjerë për ta dhe për shoqëruesit e tyre. Veshje sportive, bikini, intimo, lingerie, etj. Veshje me qera dhe kostumografi. Dekor artistik me tekstile i personalizuar ose jo, realizuar me qëndistari dhe/ose punime me dorë/makineri artizanale, piktura etj. Tekstile me pakicë për veshje dhe shtëpi. Grafic Design dhe Digital Marketing. Menaxhim rrjete sociale, përfaqësim në marrëdhëniet me publikun dhe në marrëdhëniet me të tretë, negociim kontratash. Përgatitje dokumentacioni dhe ndjekje korrespondence protokolli me institucione të tilla si QKB, AKSHI, Tatime, Dogana, Inspektoriati Punës, Zyrat e Punës, Ministria Turizmit dhe Mjedisit, Drejtoria Pronësisë Industriale, Bashki etj. Konsulencë Juridiko-Financiare. Përfaqësues tatimpaguesish.



Neni 4/2

QËLLIMI I VEPRIMTARISË

4.1 Shoqëria krijohet me qëllim që unë, themeluesia e saj të merrem me ushtrimin e veprimtarisë së lirë private dhe, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, të ushtroj aktivitet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas objektit të veprimtarisë së Shoqërisë, që pasqyrohet në Nenin 4.1 të këtij Akti.

4.2 Shoqëria mund të krijojë adresa sekondare si filiale, degë, zyra përfaqësimi, dyqane dhe çdo organ tjetër të lejuar nga dispozitat ligjore në fuqi brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

Neni 5

REGJIMI JURIDIK

5.1 Në të gjithë veprimtarinë e saj në territorin e Republikës së Shqipërisë, Shoqëria udhëhiqet dhe zbaton me korrektësi legjislacionin shqiptar në fuqi.

5.2 Të drejtat dhe detyrimet e organeve drejtuese të shoqërisë dhe themeluesia (ortaku i vetem i saj) përcaktohen më hollësisht në Statutin që i bashkëngjitet këtij Akti.

5.3 Shoqëria gëzon mbrojtje dhe sigurim të plotë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

5.4 Për evidentimin e veprimtarisë, Shoqëria do të përdorë dispozitat ligjore në fuqi dhe kërkesat e përgjithshme të kontabilitetit, siç sqarohet më hollësisht në dispozitat përkatëse të Statutit të Shoqërisë.

5.5 Shoqëria gëzon afirmim ligjor që nga dita e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

5.6 **Administrator dhe përfaqesues ligjor i shoqërisë në marrëdhënie me të tretët është ortakut themelues i shoqërisë:**

➤ **Mersilda Kamberi, sipas gjeneraliteteve si më lart;**

5.7 Administratori dhe përfaqesuesi ligjor i Shoqërisë do të jetë për një periudhë kohe prej 5 (pesë) vjetësh, duke filluar nga 30.06.2024- 29.06.2029.

Neni 6

KAPITALI I SHOQËRISË

6.1 Fillimisht, Kapitali themeltar i Shoqërisë është:

Kapitali në para: - 100.000 (Njëqindmijë) lekë, i barabartë me 1 (Një) kuota, i depozituar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, me pjesëmarrje të:

➤ Mersilda Kamberi në masën pjesëmarrëse 100(Njëqind)% të kapitalit 100(Njëqind)% të kuotës dhe 100(Njëqind)% të drejta vote;

Kapitali në natyrë: - Krahas ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë, si dhe të mundësive ekonomiko - financiare që do t'i krijohen, kontributet e saj mund të jenë edhe në natyrë (pasuri të luajtshme apo të paluajtshme ose në të drejta të vlerësueshme në para), siç do të vendosë në të ardhmen Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë.

6.2 Kapitali i Shoqërisë do të rritet ose do të zvogëlohet në përputhje me ecurinë e veprimtarisë së saj ekonomiko - financiare dhe tregëtare, si dhe të vendimeve që do të marrë në të ardhmën Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë.

Neni 7

ORGANET E DREJTIMIT TË SHOQËRISË

7.1 a) Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë.

b) Administratori dhe përfaqësuesi ligjor i shoqërisë.

7.2 Të drejtat dhe përgjegjësitë e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë, si dhe të administratorit dhe përfaqësuesit ligjor të Shoqërisë saktësohen hollësisht në Statutin e Shoqërisë.

7.3 Administratori dhe përfaqësuesi ligjor i shoqërisë, sipas nevojave që do t'i paraqiten Shoqërisë për drejtimin e veprimtarisë së saj, në të ardhmen do të vendosë edhe për krijimin e organeve të tjera të domosdoshme për drejtim, si: drejtor, zëvendës-drejtor, etj.

7.4 Për çdo çështje profesionale, si: për çështje juridike, ekonomike, financiare, teknike etj. Shoqëria do të punësojë dhe angazhojë (emërojë), sipas rastit, juristë, ekonomistë, financiarë, teknikë, ekspertë etj. në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 8

SIGURIMI I PASURISË

8.1 Pasuria e Shoqërisë do të sigurohet në Institutin e Sigurimeve të Republikës së Shqipërisë, si dhe në institute të tjera shtetërore dhe private ekzistuese dhe ato që mund të krijohen në të ardhmen sipas legjislacionit në fuqi.

8.2 Masa e pasurisë që do sigurohet, si dhe koha e sigurimit të saj do të vendoset nga organet drejtuese të Shoqërisë sipas kompetencave që do t'u japë Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë.

Neni 9

NDARJA E FITIMEVE

9.1 Pas shlyerjes së detyrimeve ndaj shtetit, si dhe ndaj personave të tretë fizikë dhe juridikë, fitimi netto i Shoqërisë mund të shpërndahet ose jo, në formën e dividendit në llogarinë e ortakut të saj, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

9.2 Gjithashtu po me vendim të Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë, fitimi ose një pjesë e tij, mund të investohet për zgjerimin e mëtejshëm të veprimtarisë së Shoqërisë.

Neni 10

LIKUJDIMI I SHOQËRISË

10.1 Rastet dhe likujdimi i Shoqërisë, si dhe ajo e mbarimit të afatit të Aktit të themelimit të Shoqërisë përcaktohen në Statutin e saj.

10.2 Ky Akt Themelimi (kontrata) për krijimin e Shoqërisë mund të zgjidhet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

10.3 Në rastet e likujdimit përfundimtar të Shoqërisë në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe me dispozitat e Statutit të saj, pushon së vepruari edhe Akti i themelimit (kontrata) e krijimit të Shoqërisë.

Neni 11

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

11.1 Ky Akt për themelimin e Shoqërisë (kontrata) ka si pjesë përbërëse të tij edhe Statutin e Shoqërisë, i cili i bashkëngjitet dhe depozitohet në organet përkatëse sipas dispozitave ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

11.2 Adresa ligjore e Shoqërisë është: Tiranë, Njësia Bashkiake Nr.4, Rruga Selaudin Zorba, ZK.8120, Nr.Pasurie 9/1313/ND +1/31, Pll.87, Shk.44, Kati 4, Ap.31.

11.3 Çdo ndryshim apo shtesë që mund t'i bëhet këtij Akti për themelimin e Shoqërisë (kontratës) dhe Statutit, duhet të bëhet me shkrim, të nënshkruhet nga ne ortaku i saj dhe të depozitohet si në dokumentet e Shoqërisë që mbahen në selinë e saj, ashtu edhe në organet përkatëse, të detyrueshme me ligj.

11.4 Ky Akt - T h e m e l i m i i Shoqërisë (kontrata) u hartua në shtatë ekzemplarë të barabartë dhe, pasi u lexua dhe u pëlqye nga unë ortaku themelues i Shoqërisë **MERKAM SH.P.K**, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, po e nënshkruaj personalisht në selinë e shoqërisë, ku do të depozitohet kopja e parë.

**ORTAKU I VETEM THEMELUES I SHOQERISE
“MERKAM” – SH.P.K.**

Mersilda KAMBERI

Mersilda Kamberi
